

METODA E KORNIZËS LOGJIKE

Qëllimet e Programit

Me të përvetësuar të këtij programi pritet që pjesëmarrësit:

- ta kuptojnë rolin dhe rëndësinë e definimit dhe analizës së problemeve si pikënisje për çdo planifikim;
- të jenë në gjendje ta definojnë sistemin e objektivave të një intervenimi shoqëror (strategjia e përgjithshme, programet ose projektet) në bazë të transformimit të trungjeve problemore në trungje të objektivave;
- ta kuptojnë strukturën e kornizës logjike dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë në procesin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë së përgjithshme, programit ose projektit;
- të jenë në gjendje të drejtojnë procesin e planifikimit me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara.

Përmbajtja

Elemente të planifikimit strategjik. Tema simuluese. Diagnostika e problemeve. Grupëzimi i problemeve. Analiza e shkaqeve dhe pasojave. Ndërtimi i trungjeve të suksesit. Analiza e opsioneve të mundshme. Kuptimi i kornizës logjike. Logjia e intervenimit. Treguesit e suksesit. Analiza e rrezikut. Plani operativ i projektit. Buxheti i projektit. Parashtrimi i projektit.

Grupi i synuar

Ky program i dedikohet personave që kanë dëshirë ta përvetësojnë metodën e kornizës logjike si mjet për planifikim në nivele të ndryshme. Kryesisht është fjala për individë nga institucinet qeveritare dhe organizatat joqeveritare, por edhe punëtorë të arsimit.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Programi organizohet në formë të një seminari 2-2.5 ditor dhe ka gjithsej **16-20 orë**. Gjithashtu, programi mund të jetë pjesë e një punëtorie të vërtetë planifikimi, e cila zgjatë 3-4 ditë.

Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja mbi 80% në seminar.